

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Driton Muharremi, Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Përparim Zeka procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit J.G. nga Gjakova, për shkak të veprave penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 nën par.1.1 të KPRK-së dhe veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e paraqitur nga vet i akuzuari J.G. dhe ankesën e mbrojtësit të tij, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë, PKR.nr.111/2017 datë 15.01.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 20.03.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.Aprovohet ankesa e mbrojtësit të akuzuarit dhe ajo e vetë të akuzuarit J.G., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë, PKR.nr.111/2017 datë 15.01.2018, vetëm përkitazi me vendimin për dënim, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës, të akuzuarin J.G. për veprën penale nën pikën I të aktgjykimit e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, për veprën penale nën pikën II e gjykon me dënim burgu në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj ashtu që konform nenit 80 të KPRK e gjykon me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit prej datës 16.10.2017 deri me datën 15.01.2018. Pjesa tjetër e aktgjykimit ngel e pa prekur.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjakovë-departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PKR.nr.111/2017 datë 15.01.2018, të akuzuarin J.G. e ka shpallur fajtorë ashtu që për veprën penale, lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 nën par.1.1 të KPRK-së, gjykata i shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 10 (dhjetë) muaj, ndërsa për veprën penale, asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-së, gjykata i shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj. Bazuar në nenin 80 të KPRK-së gjykata e gjykon me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 16.10.2017. Të dëmtuarit S.T. dhe N.T. për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohen në kontest civil. Detyrohet i akuzuari që të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 50 euro si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej 50 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Konfiskohet kmesa, si mjet i kryerjes së veprave penale.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

-I akuzuari J.G., për shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale dhe shpenzimeve të procedurës penale, me propozim që Gjykata Apelit aktgjykimin e atakuar ta anuloj dhe çështjen të ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje apo që aktgjykimin ta ndryshoj duke shqiptuar një dënim më të lehtë.

-Mbrojtësi i të akuzuarit J.G., av. T.B. për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vendimin mbi sanksionet penale dhe shpenzimeve të procedurës penale me propozim që aktgjykimi i shkallës së parë të anulohet dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje apo të ndryshohet dhe të akuzuarit të i shqiptohet dënim më i lehtë mundësisht i kushtëzuar.

- Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.67/2018 të dt. 12.02.2018 ka propozuar që ankesa e të akuzuarit J.G. dhe ajo e mbrojtësit të tij av. T.B. të refuzohen si të pa bazuara.

Gjykata e Apelit caktoi seancën e kolegjit në të cilën ftoi palët ndërsa munguan Prokurori i Apelit, i akuzuari J.G. dhe i dëmtuari S.T. edhe pse të ftuar me rregull ndërsa prezent ishte me autorizim zëvendësues av. Sh.B. i cili mbështeti ankesën e ushtruar nga kolegu i tij av. T.B..

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesat janë të bazuara.

Aktgjykimi i shkallës së parë ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilën kjo gjykatë e shqyrtoi dhe vlerësoi se aktgjykimi nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Gjykata ka dhënë arsyet lidhur me rrethanat lehtësuese dhe rënduese përkitazi me të akuzuarin J.G. dhe se në këtë drejtim ankesa është e pa bazuar ndërsa sa i përket vendimit mbi dënim e njëjta është e bazuar. Meqë kemi pranimit të fajësisë gjendja faktike nuk është kontestuar në ankesë prandaj ankesat i vlerësoi vetëm në frymën e pretendimeve ankimore e që kanë të bëjnë me vendimin mbi dënim.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij lidhur me vendimin për dënim kjo gjykatë konsideron se ankesa është e pa bazuar. I akuzuari dhe mbrojtësi i tij në ankesa theksojnë se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është i ashpër pasi që sipas të akuzuarit i njëjti ka pranuar fajësinë, të dëmtuarit nuk i janë bashkangjitur ndjekjes penale dhe me ta janë pajtuar, se është i gjendjes së varfër ekonomike, se është baba i 10 fëmijëve, është penduar thellë se gjithçka ka ndodhur pa prituri dhe premtori se në të ardhmen nuk do të përsërit veprën penale ndërsa mbrojtësi i tij shton se duhet të ketë parasysh se i njëjti është mbajtës i familjes, baba i 10 fëmijëve, më parë i pa gjykuar dhe se incidenti ka qenë i rastit, se janë pajtuar me të dëmtuarin dhe të njëjtit nuk i janë bashkangjitur ndjekjes penale. Kjo gjykatë vlerëson se duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese të cekura nga gjykata e shkallës së parë si pranimi i fajësisë, sjelljen

korrekte, kërkim faljen nga ana e të akuzuarit, më parë i pa dënuar, i gjendjes së dobët ekonomike se është mbajtes i familjes dhe baba i 10 fëmijëve (siç qëndron në gjeneralët e të akuzuarit dhe nga ankesa e tij) duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë është i ashpër edhe pse nën minimumin e paraparë ligjor dhe se dënimi i shqiptuar nga kjo gjykatë është në harmoni të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 403 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.65/18, më 20.03.2018

Procesmbajtës,
Përparim Zeka

Kryetare e kolegjit- gjyqtarja
1. Mejreme Memaj_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi_____

3. Afrim Shala _____